



Iniciativa për KOMRA
Iniciativa za REKOM
Иницијатива за РЕКОМ
Initiative for RECOM
Pobuda za REKOM

OFFICES / КАНЦЕЛАРИИ / KANCELARIJE / КАНЦЕЛАРИЈЕ / URADI / UREDI / УРЕДИ / ZYRAT

Beograd: Koalicija za REKOM
c/o Fond za humanitarno pravo
Dečanska 12, 11000 Beograd, Srbija
tel. +381 (0)11 33 49 766; fax: +381 (0)11 3232 460
e-mail: office@hlc-rdc.org

Ljubljana: Koalicija za REKOM
c/o Mirovni inštitut, Metelkova 6, 1000 Ljubljana, Slovenija
tel. +386 (1)234 7720; telefax: +386 (1)234 7721
e-mail: rekom@mirovni-institut.si

Podgorica: Koalicija za REKOM
c/o Centar za građansko obrazovanje
Njegoševa 36/I, 20 000 Podgorica, Crna Gora
tel. +382 (0)20 665 327; fax: +382 (0)20 665 112
e-mail: info@cgo-cce.org

Прилеп: Канцеларија на Коалиција за РЕКОМ
с/о Здружение на граѓани „Мировна акција“
нас. Димо Наредникот А1/2/31, 7500 Прилеп, Македонија
телефон/телефакс: +389 (0)48 401 888
е-маил: mirovnaakcija@gmail.com

Prishtine: Koalicioni për KOMRA
c/o Fondi për të Drejtën Humanitare
Eqrem Cabej 7a, 10000 Prishtine, Kosovo
tel/fax: +381 (0)38 243 488, +381 (0)38 243 490
e-mail: office.ks@hlc-kosovo.org

Prishtine: Koalicioni për KOMRA
c/o Qendra për Hulumtim
Dokumentim dhe Publikim (QHDP)
Rr. Ulpiana U-1, H 8/1, Prishtinë, 10000, Kosovë
tel. +381 (0)38 553 753; cel: +377 (0)45 321 545
E-mail: crdp.ks@gmail.com

Sarajevo: Koalicija za REKOM
c/o Udruženje/udruga BH Novinari
Kralja Tvrtka 5/5, Sarajevo, Bosna i Hercegovina
tel/fax: +387 (0)33 223 818, +387 (0)33 443 072
e-mail: bhnovinari@bhnovinari.ba

Zagreb: Koalicija za REKOM
c/o Documenta – Centar za suočavanje s prošlošću
Kuća ljudskih prava
Selska cesta 112c, HR-10000 Zagreb
tel. +385 (0)1 457 2398; fax: +385 (0)1 457 2399
e-mail: kontakt@documenta.hr

Zvornik: Koalicija za REKOM
с/о Центар информативно-правне помоћи
Вука Караџића 148
75400 Зворник, Босна и Херцеговина
тел/факс +387 (0)56 210 412
моб. +387 (0)65 520 338
е-маил: cipp@teol.net и cipp@stel.net

www.zarekom.org

Iniciativa për KOMRA: Aktualitete

Mars 2011

Koalicionin për KOMRA-në e përbëjnë 1600 anëtarë/e, duke përfshirë organizatat për të drejtat e njeriut, shoqatat e viktimave, organizatat e të rinjve, shoqatat e veteranëve, mediet, bashkësitë fetare, anëtarët e familjeve të viktimave dhe individë aktivë në promovimin e procesit të ballafaqimit me të kaluarën. Themelimin e KOMRA-së e kanë përkrahur Parlamenti i Malit të Zi, presidentët e Serbisë dhe Kroacisë, komisioni Evropian, Nënkëshilli për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit Evropian, Komisioni për punë të Jashtme i Këshillit të Evropës, Këshilli për integritet Evropian të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës, dhe më shumë se 2000 individë.

Pas procesit trevjeçarë konsultativ, Koalicioni për KOMRA-në Kuvendin e mbajtur me 26. mars, në Beograd ka miratuar Propozimin e Statutit të KOMRA-së. Kuvendi u organizua parimin delegates. Morën pjesë 122 delegatë nga BeH, Mali i Zi, Kroacia, Maqedonia, Kosova, Sllovenia dhe Serbia. Propozimi i Statutit u miratua me shumicën bindëse. Rreziku nga bllokimi i procesit u eliminua me miratimin e amendamentit të përfaqësueses së Shoqatës BeH *Gazetarët dhe Shoqata e robërve të kampeve të përqëndrimit Prijedor 92*. që së bashku me termin „shkeljet e rënda të të drejtave ndërkombëtare humanitare“ të radhiten vepra penale konkrete (gjenocidi, vrasjet, përndjekja, etj) në lidhje me të cilat KOMRA i vërteton faktet. Me këtë u arrit kompromisi mes kërkesës së avokuesve që KOMRA duhet t'i vërtetojë kryerjet e gjenocidit dhe veprat tjera penale dhe qëndrimi i qartë i të gjithë juristëve (prokurorëve, gjyqtarëve, avokatëve dhe juristëve për të drejtat e njeriut), të cilët morën pjesë në procesin konsultativ, ishte që në kompetencën e KOMRA-së nuk duhet të jetë kualifikimi ligjor i veprave penale.

Promovimi i Iniciativës për KOMRA

1. Në kuadër të Ditës kundër fashizmit në Opati (Kroaci) me datën 2. mars është organizuar tryeza e rrumbullakët *Guximi qytetar* në të cilën u prezantua Iniciativa për KOMRA. Iniciativa u vu në kontekstin e domosdoshmërisë dhe guximit qytetar të aktivistëve dhe aktivisteve që përmes debatit rajonal mbi mekanizmin e drejtësisë tranzicionale shoqëritë e ish-Jugosllavisë të ballafaqohen me anët e errëta të së kaluarës.

2. Në festivalin Ndërkombëtarë të filmit Zagrebdox, Documenta, me 3. mars, ka prezantuar



Iniciativën për KOMRA.

3. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në tubimin „Gruaja... lufta... dhuna“, në Shkup (Maqedoni), anëtarët e Koalicionit për KOMRA kanë prezantuar Iniciativën për KOMRA. Takimi kaloi në shenjë të kujtimit të viktimave të grave në luftërat në ish-Jugosllavi, në shenjë të nevojës që për këtë të dëshmojnë gratë të cilat kanë përvojat e rënda.

4. Në Lubjanë, Slloveni, me 22. mars janë mbajtur Konsultimet me shoqërinë civile mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së. Në takim morën pjesë rreth 30 përfaqësues të shoqatave të të shlyerve (fshirëve), veteranë, organizata joqeveritare dhe intelektualë.

Pjesëmarrësit e mbështetën idenë për themelimin e komisionit rajonal, ndërkombëtarë për hapësirat e ish RSFJ-së, dhe theksuan se qasja rajonale është më e qëlluara, për hulumtimin e krimeve dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të cilat kanë ndodhë për njëzetë vite. Përfaqësuesit e të fshirëve edhe një herë theksuan rëndësinë e komisionit rajonal, e cila me ndihmën e dëgjimeve publike, hulumtimin e fakteve, dhe referimin në përgjegjësinë politike të përfaqësuesve të pushtetit, mund t'i kontribuojë satisfaksionit moral të të gjithë viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në territorin në ish Jugosllavi. Një përfundim i rëndësishëm i diskutimit, ishte që komisioni i ardhshëm ndërkombëtarë, përmes vërtetimit të fakteve të bazuara, mund të ndërtojë bazën për interpretimet e ardhshme historike të luftërave dhe ngjarjeve të cilat u kanë ndodhë. KOMRA mund të kontribuojë ndjeshëm në ndryshimin e qëndrimit të opinionit publik për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera dhe t'i kundërvihet manipulimeve politike dhe refuzimit të krimit.

5. Delegatët e Kuvendit të katërt të Koalicionit për KOMRA-në, në mbledhjen e mbajtur me 26. mars në Beograd, kanë miratuar raportin për procesin konsultativ, fushatën mediale, avokimin publik dhe përgatitjet për fushatën për mbledhjen e nënshkrimeve.

Në diskutimin për planifikimin e fushatës për mbledhjen e nënshkrimeve, delegatët i kanë pasë parasysh rezultatet e hulumtimit të qëndrimeve të opinionit publik në Serbi, Kroaci, BeH, Maqedoni, Malin e Zi dhe në Kosovë, mbi Iniciativën për KOMRA-në, të cilën e ka realizuar agjensioni *Ipsos Public Affairs*. Të dhënat tregojnë se Iniciativa për KOMRA-në ka hasë në reagim të favorshëm te qytetarët në të gjitha shtetet, të përfshirë në këtë hulumtim. Mbështetja më e madhe për themelimin e KOMRA-së është në Kosovë, ku 90% të të anketuarve ka shprehë mbështetjen e tyre për themelimin e Komisionit rajonal. Është me rëndësi të theksohet se mbështetja për themelimin e KOMRA-së në BeH është në nivel shumë më të ulët se sa mbështetja e qytetarëve në Federatën BeH, në të cilën 88% të të anketuarve kanë shprehë mbështetjen për themelimin e Komisionit rajonal. Niveli më i ulët i mbështetjes për themelimit të KOMRA-së është shënuar në Kroaci, ku vetëm rreth 60% të të anketuarve mbështetën këtë iniciativë. Optimizmi për suksesin e KOMRA-së (që të hartojë listën me emra të të vrarëve, të rënëve, zhdukurve) është më i vogël në krahasim me mbështetjen për themelimin e Komisionit rajonal. Optimizmi më i vogël është te qytetarët e Kroacisë (23%) dhe të Serbisë (36%), ndërsa më i madhi është te qytetarët e Kosovës dhe të Federatës BeH.

6. Iniciativa për KOMRA-në është prezantuar në Konferencën për kulturën politike dhe dialogun, me 28. mars në Shkup, Maqedoni. U theksua se dialogu është pjesë përbërëse e kulturës politike, dhe në momentin kur nuk ka kësi dialogu lindin mosmarrëveshjet të cilat çojnë deri te konfliktet dhe luftërat. Në konferencë u promovua revista *Zgjidhjet (Rešenja)*, pjesa më e madhe e së cilës i është kushtuar Inicativës për KOMRA-në.



7. Organizata ndërkombëtare Impunity Watch (IW), e cila i ofron mbështetje procesit të drejtësisë tranzicionale në shtetet post-jugosllave, i ka dërguar me 28. mars Koalicionit për KOMRA-në një letër mbështetjeje dhe ftesë parlamenteve të shteteve pasuese të RSFJ-së së dikurshme që të ndërmarrin hapat e domosdoshëm për themelimin e KOMRA-së. IW fton parlamentet nacionale që t'i marrin parasysh kërkesat e shoqërisë civile, të cilat e kanë fituar legjitimitetin në procesin konsultativ trevjeçarë, dhe pa vonesë të mbështesin rastin që të ndërmarrin aksion bindës në luftën kundër mos-ndëshkimit për krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera gjatë njëzet viteve në konfliktet e armatosura në RSFJ-në e dikurshme.

8. Mbështetjen politike për themelimin e KOMRA-së gjatë muajit mars 2011, e ofruan Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (Kosovë), Partia Popullore *Me punë për progres* (BeH), dhe grupet parlamentare në Kuvendin Popullor të Republikës së Serbisë.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, në takimin me anëtarët e Koalicionit për KOMRA-në, me 16 mars, ka mbështetë themelimin e Komisionit rajonal dhe ka shprehë bindjen se të gjitha grupet parlamentare do ta mbështesin Iniciativën, atëherë kur ajo do t'u prezantohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini në takimin me 18. mars, ka mbështetë themelimin e KOMRA-së dhe ka ftuar anëtarët e Koalicionit për KOMRA-në në bashkëpunim të ngushtë të ndërsjellët.

9. Në Sarajevë me 28. mars, Iniciativën për themelimin e KOMRA-së e ka mbështetë kryetari i Partisë Popullore *Me punë për progres*, Mladen Ivanković Lijanović: „Pa një dialog kualitativ dhe me argumente nuk mund të arrijmë asgjë. Për shkak të gjeneratave të cilat do të vinë, ne duhet ta trajtojmë këtë problem në bazë të fakteve, dhe ta ndajmë tërë procesin nga politizimi dhe keqpërdorimet politike. Ne në Partinë Popullore *Me punë për progres* shprehim mbështetjen tonë për të gjithë ata të cilët e përfaqësojnë të vërtetën dhe të cilët i qasen zbulimit të vërtetës në bazë të parimit të respektit dhe dialogut ndër-etnik. E mbështesim këtë iniciativë, edhe për arsyen sepse e trajton tërë rajonin“.

Themelimin e KOMRA-së e kanë mbështetë edhe grupet parlamentare të Partisë Socialiste të Serbisë, Partisë Demokratike dhe grupi parlamentarë i pakicave, të cilat e përbëjnë koalicionin në Kuvendin Popullor të Republikës së Serbisë.

Përgaditjet për fushatën 1.000.000 nënshkrime për KOMRA-në

1. Në kuadër të përgatitjeve për fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve në Serbi, Kroaci, Slloveni dhe në Kosovë është bërë thirrje publike për vullnetarët të marrin pjesë në mbledhjen e nënshkrimeve. Në Serbi është organizuar trajnimi për vullnetarët në Kragujevc, Valjevë, Priboj dhe Prijepole.

Koordinatorët e fushatës, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi dhe Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci, kanë zgjedhë organizatat partnere në BeH, Maqedoni, Slloveni, dhe kanë krijuar rrjetin i cili do të marrë pjesë në koordinimin e fushatës në Serbi, Kroaci, BeH, Kosovë, Maqedoni, Në Slloveni, krijimi i rrjetit është në rrjedhë e sipër.

Iniciativat e të rinjve për të drejtat e njeriut kanë organizuar trajnime për udhëheqjen e fushatës me internet.

2. Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Serbi, në Fakultetin Filozofik në Beograd (28. mars) dhe në Novi Sad (01. prill), në panelin për diskutim „Të dihet, të mos përsëritet“, ka prezantuar Iniciativën për KOMRA-në dhe fushatën **1.000.000 nënshkrime për KOMRA-në**. Sipas fjalëve të



pjesëmarrësës së takimit në Novi Sad, deputetja Aleksandre Jerkov tha „e vërteta është argumenti më i madh për mbështetje. Prandaj, është obligim i secilit prej nesh që të punojmë në të vërtetën, tu flasim për të atyre që duan të na dëgjojnë, por edhe atyre që ndoshta nuk duan të na dëgjojnë. Faktet janë rruga e vetme drejt të vërtetës. E vërteta është rruga e vetme drejt pajtimit“. Pas këtij panelit debatues, 20 studentë janë lajmëruar vullnetarë për fushatën e mbledhjes së nënshkrimeve.

3. Në kuadër të programit *Bashkëngjitu!* me të cilin organizatat e shoqërisë civile e promovojnë programin e cili fton në angazhim qytetarët, në Fakultetin e shkencave politike në Zagreb, 3. mars, është prezantuar Fushata **1,000,000 nënshkrime për KOMRA-në**. Në pultet për informim të interesuarit janë informuar për Iniciativën dhe janë paraqitur për punën vullnetare në fushatë.

4. Koalicioni për KOMRA-në ka krijuar kontakt me organizatat kryesore boshnjako-hercegovase në diasporë në SHBA, Holandë, Gjermani, Australi, Suedi dhe Danimarkë, dhe i ka informuar për Iniciativën për KOMRA-në. Udhëheqësit e shoqatave do ti informojnë anëtarët mbi Iniciativën për KOMAR-në dhe do t'i ftojnë për mbështetjen e tyre për themelimin e KOMRA-së.

Fushata në media

1. Në Televizionin Mitrovica (Kosovë), me 6. mars është emituar drejtpërdrejtë emisioni me emrin „Urat“, emision dy-orësh për KOMRA-në, të cilin morën pjesë anëtarët e Koalicionit për KOMRA-në, Nora Ahmetaj, Bekim Blakaj dhe Avni Melenica.

Në Beograd (Serbi), 11. mars, B92 ka emituar emisionin e dytë të serisë „*Duart plot me të kaluarën*“, bisedën për KOMRA-në me deputeten e Kuvendit Popullor të Serbisë, Vesna Pešić.

Televizioni Kosovar RROKUM, me 11. mars, ka emituar emisionin një-orësh, bisedë në studio për KOMRA-në, me Nora Ahmetaj dhe Arsim Gërzhaliun.

Koha Vision, TV stacioni në Prishtinë (Kosovë), në emisionin 45 minutash „Matinee“, ka emituar bisedën drejt për drejtë për KOMRA-në, me Bekim Blakaj,

2. Shfaqja teatrale „Analogjitet“, Teatri i familjeve të lumit të kthjellët nga Serbia, e cila promovon Iniciativën, ka shfaqë shfaqjen teatrale dy herë në Shkup, 31. mars dhe 01. prill 2011.

3. Me rastin e ardhjes së shfaqjes së teatrale „Analogjitet“ në Slloveni, në muajin shkurt 2010, gazeta ditore „*Mladina*“ me 4. mars, ka publikuar intervistën me drejtorin e fushatës mediale të Iniciativës për KOMRA-në. Lazar Stojanovic mbi Iniciativën për KOMRA-në.

Portali Kroat TPortal ka publikuar, me 23 mars, intervistën me Nataša Kandić lidhur me Iniciativën për KOMRA-në.

4. Që nga fillimi i faqes [Za rekom Për komra For recom na Facebook](#), me 7. tetor 2010 deri 31. mars 2011, 1,220 vizitorë të faqes www.facebook.com kanë shprehë përkrahjen në këtë faqe interneti. Në muajin mars, faqja e internetit të KOMRA-së është vizituar 76.675 herë. Ndër vizitorët e kësaj faqeje: 53 % janë femra, 41 % janë të moshës mes 25 dhe 34 vjeç, më së paku ka vizitorë të moshës mbi 55 vjeç (44 %). Numri më i madh i vizitorëve të faqes www.facebook.com të cilët kanë shpreh mbështetjen për Iniciativën për KOMRA-në janë nga Serbia – 623, nga Kroacia - 108, nga BeH - 115, nga Mali i Zi – 67, nga Kosova – 110, nga Maqedonia – 25, nga Sllovenia – 9, etj.



Që nga fillimi i saj, deri në përmbyllje me 31. mars, ne faqen [Za rekom Për komra For recom](#), në këtë faqe janë postuar 1.054 tekste, fotografi dhe dokumente, të cilat janë shikuar 333.283 herë.

5. Në muajin mars web faqja www.zarekom.org/www.perkomra.org është vizituar shumë, Gjithsej 4.028 vizitorë e kanë shikuar këtë sajt, 21.790 herë. Mesatarisht secili vizitorë ka qëndruar në sajt 3 minuta dhe 27 sekonda, dhe nga numri i përgjithshëm i vizitorëve 39.32 % janë ata të cilët më shumë se një herë e kanë vizituar këtë faqe.

Që nga nisma e sajtit të ridizajnuar www.zarekom.org/www.perkomra.org, dhe në bazë të statistikave Google Analytic, vizitueshmëria në sajt është rritë për 256.48 %.

Gjithsej që nga 1. qershor 2010, dhe përmbyllur me 31. mars 2011, ka pasë 12.965 vizitorë në këtë faqe, duke e shikuar 56.752 herë. Numri më i madh i vizitorëve në web faqe ka qenë nga linku nga faqja në Facebook (2.348).

6. Në muajin mars, në Forumin e sajtit www.zarekom.org/www.perkomra.org janë regjistruar 10.148 shfrytëzues. Gjithsej në Forum janë paraqitur 49 tema dhe 36 postime. Në muajin mars janë vendosur linket sipas Forumit www.zarekom.org/www.perkomra.org në më shumë se 450 forume tjera të cilët merren me drejtësinë tranzicionale.

Mbështetja nga jashtë

Janë identifikuar kontakt personat/grupet në Britani, Francë, Kanada, Zelandë të Re dhe SHBA, të cilët kanë pranuar të jenë agjentë të Inicativës për KOMRA-në në procesin e mbështetjes. Është krijuar kontakti me dy rrjete të mëdha shoqërore ndërkombëtare për mbështetje publike (Avaaz-Avaaz dhe Racoon).